

**PERMBLEDHJE JOTEKNIKE E RAPORTIT
TE VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS
PER AKTIVITETIN:
"TREGTIMI DHE MAGAZINIMI I NAFTAES
DHE NENPRODUKTEVE TE SAJ"**

**Vendodhja : Prane rruges "Eleni
Gjika", Lagja "Mbrostar Ferko",
Bashkia Fier.**

Kërkues: Subjekti: "LIONA" sh.a

Hartoi raportin e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:
"ENVIRONMENTAL MANAGEMENTS CONSULTANTS" Sh.p.k

Administrator
Elidiana Shehu



Altin Ahmeti
(Çert. 261, Nr. 11657 Prot, dt. 10.12.2014)

Ing. Elidiana Shehu
(Lic. 146, Nr. 5113 Prot, date 28.07.2013)

Nentor, 2018

Pasqyra e lendes:

1	PERMBLEDHJE	2
1.1.	Hyrje	2
1.2.	Karakteristikat e projektit, te dhena te pergjitheshme.....	3
2	KUADRI LIGJOR, RREGULLATOR PER VNM.....	3
2.1	Qellimi i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis.....	3
2.2	Kuadri ligjor kombetar	4
2.3	Permbledhje e kuadrit ligjor	5
3	PERSHKRIM I MJEDISIT EKZISTUES.....	6
3.1.	Pershkrim i pergjithshem per Qarkun Fier	6
3.1.1	Bashkia e Fierit	6
	Karakteristika te pergjithshme te mjedisit natyror	8
	Ekonomia	9
	Kushtet gjeografiko-natyrore	11
	Klima	12
	Sizmiciteti.....	12
	Gjeologjia dhe Dherat	12
	Hidrologjia, ujrat siperfaqesore dhe nentokesore	12
	Mjedisi biologjik.....	13
4	PERSHKRIMI I PROJEKTIT	14
4.1.	Te pergjithshme mbi aktivitetin	14
4.2.	Vendodhja e aktivitetit	15
5.	IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS DHE MASAT PER MINIMIZIMIN E TYRE	15

1 PERMBLEDHJE

1.1. Hyrje

Burimet natyrore, energjia dhe mjedisi janë kushtet më të rëndësishme për mbijetesën e njeriut. Ato janë elementet më të rëndësishme për zhvillimin e qëndrueshëm. Me zhvillimin e shoqërisë njerëzore kërkesat për lende të para vijnë duke u rritur, ndërkohe që burimet natyrore dhe energjia vijnë duke u varferuar. Nga ana tjetër prodhimi i mbetjeve nga konsumi i materialeve ka shkaktuar ndotje serioze në mjedis, duke rrezikuar mbijetesën e qenieve të gjalla, në të cilat mbetjet plastike, mbetjet nga gomat janë material të qëndrueshëm me një rezistencë të lartë ndaj nxehtësisë, veprimeve mekanike dhe janë të vështira për tu degraduar për shkak të strukturës së tyre molekulare. Degradimi i tyre kërkon dekada, madje shekuj.

Rruga më e lehtë e trajtimit të mbetjeve është djegia mbi bazën e një teknologjie miqësore me mjedisin apo landfillimi i tyre. Landfilli kërkon sipërfaqe të mëdha tokë. Opsioni i djegies së tyre në kushte të caktuara teknologjike, mbetet opsioni më i mirë i përdorur sot në USA dhe Europë, duke kursyer jo vetëm burimet tokësore, por krijon edhe bazat për një energji të re.

Legjislacioni kombëtar, direktivat europiane të fushës së mjedisit dhe konventat ndërkombëtare, në të cilat vendi ynë është palë, parashtrajnë kërkesa që synojnë mbrojtjen e shëndetit human dhe mbrojtjen e mjedisit si një të tërë.

Trajtimi i integruar, kërkon zbatimin e politikave ekonomike, sociale dhe mjedisore në një mënyrë të përfortuar reciprokisht. Megjithatë, duhet gjetur një ekuilibër midis nivelit të shfrytëzimit të mjedisit dhe mbrojtjes së tij. Vonesat në përshtatjen e këtij trajtimi të integruar dhe vazhdimësia me veprimtari, të cilat e dëmtojnë së tepërmi mjedisin, rrezikojnë shëndetin publik dhe pakësojnë cilësinë e jetës, do të çojnë në një rritje të mëdhe të kostos së përgjithshme të zhvillimit ekonomik.

Objekti i raportit të përmbledhur të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të projektit **“Magazinimi dhe tregtimi i naftes dhe nenprodukteve të saj”**, me vendodhje pranë rrugës “Eleni Gjika”, Lagja “Mbrostar Ferko”, Bashkia Fier, është:

- përcaktimi, përshkrimi dhe vlerësimi i ndikimeve të pritshme mjedisore të zbatimit të projektit.
- propozimin e masave të nevojshme për parandalimin, reduktimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve negative në mjedis.

1.2. Karakteristikat e projektit, te dhena te pergjitheshme

Shoqëria "LIONA" Sh.a, me NIPT. L31731005C, me seli ne rrugen "Nikolla Tupe", Pallati nr. 1, Ap 4, kt 5. dhe me administrator Z. Klodian Vathi.

Ky aktivitet do te ushtrohet ne ambjentet prane rruges "Eleni Gjika", Lagja "Mbrostar Ferko", ne periferi te qytetit te Fierit, Bashkia Fier. Aktiviteti i depozitave te karburanteve eshte nje investim i standarteve te vendeve te Bashkimit Europian, ku te gjitha materialet jane importuar nga Italia. Ne keto ambjente zbatohen standarte te larta sigurie dhe higjene .

Krahas depozitave te medha te depozitimit te karburanteve eshte ndertuar edhe nje depozite uji me permasa te medha, e pershtatshme per nevojat e sistemit zjarr-fikes. Ne ambjentin e punes jane instaluar te gjitha pajisjet zjarr-fikese me infrastrukturen e nevojshme per te qene nje sistem i pa varur dhe shume eficient.

Rreth depozitave eshte ndertuar nje vaske prej betoni ne nje lartesi prej rreth 3 m e cila sherben per grumbullimin e lendes se depozituar ne raste te avarive ne sistem.

2 KUADRI LIGJOR, RREGULLATOR PER VNM

2.1 Qellimi i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis

VNM eshte nje proces sistematik per te percaktuar dhe vleresuar efektet apo ndikimet ne mjedis te nje veprimi apo projekti te caktuar. Ne nje situatë normale, ky proces aplikohet perpara se te merret vendimi dhe te fillojne angazhimet per realizimin e projektit. Po sidoqofte, dhe ne çdo kohe, efektet sociale, kulturore dhe shendetesore jane konsideruar si pjese integrale e VNM. Kujdes i veçante i kushtohet praktikave te VNM per te parandaluar dhe minimizuar efektet e mundshme negative te veprimeve te ndermarra.

Qellimi i VNM eshte te:

- Te jape informacion per vendimmarresit per pasojat mjedisore te studimet e propozuara; dhe
- Te promovojë zhvillimin miqësor dhe te qendrueshem me mjedisin duke identifikuar masat e duhura per permiresimin dhe zvogelimin e ndikimeve ne mjedis

Reduktimi i ndikimeve ne mjedis arrihet nese nje zhvillim behet i qendrueshem me mjedisin. Keto ndikime jane mjaft komplekse, me te medha ne shkalle dhe per me teper shtrijne pasojat e tyre me shume se 10 vjet me pare ku u fut koncepti i VNM ne vendin tone. Si rezultat, VNM eshte kthyer ne nje vegël kyç per vendimarrjen per nje zhvillim te propozuar.

Ne aspektin nderkombetar, roli i VNM eshte njohur ne Principin e 17 te Deklarates per mjedisin dhe Zhvillimin.

VNM, si nje instrument kombetar duhet te aplikohet per aktivitetet e propozuara te cilat pritet qe te kene ndikim negativ ne mjedis dhe jane subjekt i nje vendimmarrje te nje autoriteti kombetar.

Qellimi dhe objektivat e VNM mund te ndahen ne dy kategori.

Qellimi i pare, drejtperdrejte, eshte te informoje procesin e vendimarrjes duke identifikuar te konsiderueshem potencialet ne mjedis dhe rreziqet e perfitimet e projektit dhe zhvillimit te propozuar.

Qellimi perfundimtar, afatgjate i VNM eshte te promovoj zhvillimin e qendrueshem duke siguruar qe propozimet e projektit nuk minojne burimet natyrore dhe funksionet ekologjike ose mireqenien, stilin e jetes dhe jetesen e komunitet si dhe te njerezve qe lidhen apo varen nga ky projekt ose aktivitet.

Objektivat afatshkurter dhe te drejtperdrejte te VNM:

- Permiresim nga pikepamja mjedisore i propozimit dhe projektit;
- Siguron qe burimet natyrore jane perdorur ne menyren e duhur dhe me eficence;
- Identifikon masat e duhura per zvogelimin e ndikimeve te mundshme potenciale te projektit apo propozimit; dhe
- Lehteson informimin e vendimmarresit, duke perfshire vendosjen e termave dhe kushteve mjedisore per zbatimin e projektit apo propozimit.

Objektivat afatgjate te VNM jane:

- Siguron dhe mbron shendetin e njeriut;
- Parashikon dhe perjashton ndryshimet e pakthyeshme dhe demtimet serioze te mjedisit;
- Ruan dhe mbron burimet natyrore, peisazhet e natyres dhe komponentet perberes te ekosistemeve;
- Permireson aspektet sociale te projektit

2.2 Kuadri ligjor kombetar

Sa me siper, ky Raport i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, eshte mbështetur ne legjislacionin mjedisor si me poshte dhe ka per qellim qe te identifikoj, parashikoj dhe parandaloje ndikimin e këtij aktiviteti ne mjedis.

Kuadri ligjor për VNM-ne sigurohet ne menyre te drejtperdrejte nga dy ligje për mjedisin në Shqipëri Ligji Per mbrojtjen e mjedisit dhe Ligji per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis. Keto ligje se fundmi jane perafruar plotesisht me ligjet e Bashkimit Europian per mbrojtjen e mjedisit dhe Vlersimin e Ndikimit ne Mjedis.

Ligji mbi Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis (VNM) përcakton tipin dhe shkallen e projekteve apo veprimtarive qe kerkojne VNM para implementimit. Kategorite e VNM-ve jane:

VNM paraprake. Ky vlen per projekte qe mund te kene impakte potenciale me te vegjel ne permasa qe serish kerkojne nje vleresim profesional te impakteve te tyre. Keto perfshijne projekte qe jane listuar ne Shojcen 2 te Ligjit per VNM dhe ndryshime apo rehabilitime te projekteve te listuar ne Shtojcen 1 dhe qe nuk klasifikohen ndryshe nga AKM.

VNM i Thelluar. Ky vlen per projekte me impakte potencialisht te konsiderueshme, siç figurojne ne listen e Shojces 1 te Ligjit, ato projekte te listuara ne Shtojcen 2 per te cilet Agjencia Kombetare e Mjedisit mendon se do te kene nje impakt te konsiderueshem mbi mjedisin (bazuar ne informacionin e siguruar nga

propozuesi ne kohen e aplikimit) dhe veprimtarite qe jane per tu implementuar ne zonat e mbrojtura apo zona bregdetare te Republikes se Shqiperise.

2.3 Permbledhje e kuadrit ligjor

Nder ligjet e tjera te legjislacionit kombetar ne lidhje me aktivitetin, këtë VNM dhe mjedisin përfshijnë :

- Ligji Nr 10431 datë 09.06. 2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit"
- Ligji Nr 10440 datë 07.07. 2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit Në Mjedis"
- Ligj Nr. 10448, date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit"
- Ligji Nr. 10463 date 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve"
- Ligji Nr.8897 datë 16.05.2002, "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja".
- Ligji Nr.10 081, datë 23.02.2009 "Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë".
- Ligj Nr.9115, datë 24.7.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura"
- Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit"
- Vendim nr. 686, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore"
- Vendim Nr.1189, Datë 18.11.2009 "Për Rregullat dhe Procedurat për Hartimin dhe Zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit"
- Vendimi Nr.247, datë 30.04.2014 "Për tërheqjen e mendimit te publikut në vendimmarrje për mjedisin".
- Vendim Nr. 123, datë 17.2.2011 "Per menaxhimin e zhurmave"
- Vendim Nr. 313, dt. 09.05.2012 "Per rregulloren e mbrojtjes se publikut nga shkarkimet ne mjedis"
- Vendim Nr. 177, datë 6.3.2012 "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre"
- Vendim Nr. 452, datë 11.7.2012 "Për lendfillet e mbetjeve"
- Vendim Nr. 177, datë 31.3.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse"
- Vendim Nr. 538 dt.26.05.2009 "Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet QKL dhe disa rregulla te tjera"
- Vendim i Nr. 419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL.

3 PERSHKRIM I MJEDISIT EKZISTUES

3.1. Pershkrim i pergjithshem per Qarkun Fier

3.1.1 Bashkia e Fierit

Zona Gjeografike: Bashkia e re Fier kufizohet në veri me bashkinë Divjakë, në lindje me bashkitë Patos dhe Roskovec, ndërsa në jug me bashkinë Vlorë. Ajo shtrihet në Ultësirën Perëndimore, mes lumenjve Seman dhe Vlorë. Pjesa dërrmuese e bashkisë së re shtrihet në zonë fushore të ulët ndërsa komunat Cakran dhe Frakull kanë territor kodrinor. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Fierit.



Harta territoriale e bashkisë Fier

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011 në territorin e bashkisë së re banojnë 120.655 njerëz ndërsa në regjistrin civil rezultojnë banorë 196.324 njerëz. Sipërfaqja e bashkisë së re është 619.9 km². Në bazë të censurit, densiteti i popullsisë është 194.6 banorë për kilometër katror ndërsa në bazë të regjistrit civil, densiteti është 316.70 banorë/km².

Kjo bashki përbëhet nga dhjetë njësi administrative, të cilat janë: Fier, Cakran, Mbrostar Ura, Libofshë, Qendër, Dërmenas, Topojë, Levan, Frakull dhe Portëz. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Fierit dhe qarkut Fier. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 85 fshatra.

MAGAZINIMI DHE TREGTIMI I NAFTES

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Fier	Qyteti Fier	Fier	Qyteti Fier	120,655	196,324	619.9
		Cakran	Fshatrat; Cakran, Cakran i Ri, Floq, Buz Madh, Hambar, Varibop, Vjosë, Kreshpan, Gjorgos, Vreshtas, Gorishovë, Gjonç			
		Mbrostar Ura	Fshatrat; Mbrostar, Verri, Vajkan, Petov, Kallmi i Madh, Kallmi i Vogël			
		Libofshë	Fshatrat; Libofshë, Rreth Libofshë, Vanaj, Daullas, Agimi, Metaj, Gozhdaras, Havaleas, Ndërnënas, Hasturkas, Adriatik			
		Qendër	Fshatrat; Çlirim, Mujalli, Grecalli, Daullas, Afrim i Ri, Vadhizë, Zhupan, Drizë, Drizë Myrteza, Romët			
		Dërmenas	Fshatrat; Dërmenas, Pojan, Kryegjatë, Havaleas, Hoxharë, Radostinë, Sulaj, Hamil, Muçaj, Baltëz, Povelçë, Darëzeze e Re			
		Topojë	Fshatrat; Topojë, Seman, Gjokalli, Sheq Marinas, Sheq, Fushë, Grykë, Seman i Ri, Kavaklli			
		Levan	Fshatrat; Levan, Ferras, Peshtan i Madh, Peshtan i Vogël, Shtyllas, Bishan, Bashkim, Boçovë, Martinë, Pishë Poro, Qarr			
		Frakull	Fshatrat; Frakull e Madhe, Frakull e Vogël, Adë, Peshtan Bregas, Kafaraj, Kashishtë, Sheq Musalala, Çerven			
		Portëz	Fshatrat; Portëz, Mbyet, Plyk, Kraps, Lalar, Patos Fshat			

Bashkia e Fierit përfshin zonat bujqësore më të rëndësishme të vendit, si dhe një pjesë të konsiderueshme të industrisë që lidhet me përpunimin e naftës.

Më shumë se 55 për qind e popullsisë së bashkisë së re jetojnë në zonat rurale, gjë që tregon rëndësinë e sektorit të bujqësisë në jetën ekonomike të bashkisë së re. Prodhimi bujqësor i kësaj zone është i shumëllojshëm nga drithi te zarzavatet, bostanoret, blegtoaria dhe nënproduktet e saj.

Në territorin e bashkisë së re gjenden toka shumë pjellore, të cilat dikur kanë qenë kënetat dhe që sot janë të rrezikuara vazhdimisht nga përmbytjet.

Bashkia e re do të ketë një vijë bregdetare të konsiderueshme që shtrihet nga grykëderdhja e lumit Vjosë deri në grykëderdhjen e lumit Seman në kufijtë e parkut kombëtar Divjakë-Karavasta.

Si një zonë industriale e rëndësishme e kohës së komunizmit, Fieri vuan në veçanti nga papunësia e lartë e shkaktuar nga mbyllja e fabrikave, si dhe nga ndotja mjedisore e lënë pas nga industria tashmë e mbyllur. Përveç ndotjes së trashëguar, qyteti rrezikohet edhe nga ndotja që shkaktohet nga industria që ka mbijetuar. Pjesa më e madhe e ndotjes vjen nga industria e naftës dhe rafineritë e vajit ushqimor, të cilat ndosin ajrin sidomos gjatë periudhës së natës.

Bashkia e re ka një vijë bregdetare të konsiderueshme, si dhe pjesë e saj është dhe parku arkeologjik i Apollonisë, krahas objekteve të tjera të trashëgimisë kulturore.

Shfrytëzimi i bregdetit për turizëm është ende në fillesat e veta. Njësitë administrative Topojë dhe Dërmenas kanë një vijë bregdetare ranore prej 30 kilometrash, e gjitha shumë e përshtatshme për turizmin familjar. Vlerësohet se rreth 10 mijë vetë në vit sakaq zgjedhin këtë vijë bregdetare për pushime verore, kryesisht afatshkurtra.

Rehabilitimi i territorit të dëmtuar nga industria si dhe pastrimi i ujërave identifikohen si dy ndër sfidat kryesore të bashkisë së re, të cilat lidhen ngushtë dhe me zhvillimin e turizmit të qendrueshëm në këtë zonë. Ndalimi i ndotjes industriale apo të ujërave të lumenjve, veçanërisht Semanit, mund të ndihmojë në zhvillimin e një mjedisi të pastër dhe të përshtatshëm për turizmin.

Zgjerimi i funksioneve të bashkisë ekzistuese të qytetit të Fierit në një territor të gjerë pritet të përbëjë një tjetër sfidë, veçanërisht për shkak të nevojave shumë të ndryshme nga qyteti që kanë të 85 fshatrat që përfshihen në bashkinë e re. Në zonat rurale, mirëmbajtja e infrastrukturës së vaditjes dhe kullimit të cilat janë përgjegjësi e pushtetit vendor identifikohen nga komuniteti si shqetësimet kryesore.

Zona e bashkisë së re, përfshirë edhe vetë qytetin e Fierit, janë shumë të prekura nga përmbytjet e shpeshta, rrjedhimisht shtimi i investimeve në infrastrukturën mbrojtëse nëpër komunat përgjatë lumit Vjosë edhe mirëmbajtja e infrastrukturës ekzistuese, pastrimi i shtrateve të lumenjve dhe kontrolli i ndërtimeve pa leje përgjatë lumit Gjanicë identifikohen ndër sfidat kryesore të cilat pritet të përballet bashkia e re.

Bashkia e Fierit ka një sërë problemesh infrastrukturore. Rrugët e brendshme të qytetit janë tërësisht të amortizuara dhe investimet raportohen të mangëta. Rrugët lidhëse me shumë fshatra janë në gjendje të keqe. Krijimi i një shërbimi për transportin publik në shërbim të të 85 fshatrave mund të ndihmojë në zhvillimin e jetës komunitare brenda njësisë së re administrative, si dhe marrjen e shërbimeve më lehtë të aksesueshme.

Një ndër problematikat e tjera të rëndësishme për komunitetin e kësaj bashkie të re është dhe furnizimi me ujë të pishëm dhe kontrolli i cilësisë së tij

Karakteristika te pergjithshme te mjedisit natyror

Rrethi I Fierit ofron dhe potenciale te rëndësishme natyrore për zhvillimin e tij. Ne përgjithësi kemi te bëjmë me një rajon fushor me lartesi nga 0-100 m mbi nivelin e detit dhe me toka shumë pjellore. Edhe relievet kodrinore janë pergjithesisht te buta dhe te mundshme për shfrytezim bujqesor. Ne zonat e rrafsheta zhvillohen tokat e hirta kafe. Kemi edhe lloje te veçanta tokash si aluvionale qe takohen ne luginat e Semanit e Vjoses, tokat e kripura qe shtrihen ne Hoxhare si dhe tokat mocalishte te Roskovecit.

Ne rrethin e Fierit shtrihet një pjesë e Myzeqese se Madhe, Myzeqeja e Vogel dhe fushat e Frakulles e te Cakranit. Fieri ashtu si e gjithë Shqipëria bën pjesë ne brezin e klimes mesdhetare, dhe dallohet për tipare me te shprehura mesdhetare, e cila karakterizohet nga vera e nxehte dhe e thate me shkelqim të madh te diellit dhe dimeri i bute dhe me rreshje te mëdha. Ngricat dhe debora janë dukuri tepër te rralla. I nxehti fillon qysh nga mesi i pranveres dhe vazhdon deri në fund te tetorit.

Klima e Fierit është e ngrohte sepse Fieri laget nga deti dhe është i mbrojtur nga lindja prej ererave te ftohta. Fieri dallohet për numerin e lartë te ditëve me diell mesatarisht 2800 ore ne vit. Rreshjet kanë rregjim kohor shumë te crregullt ato janë perqendruar kryesisht ne gjysmen e ftohte te vitit, sasia mesatare e tyre arrin 980-1000mm/vit. Vera ne Fier është e thate dhe shpesh nuk bie shi për jave te tera.

Muajt me te lagesht janë nentori dhe janari, kurse muajt me te thate korriku dhe gushti. Ererat fryjne ne drejtime të ndryshme por gjatë dimrit mbizotëron era e jugut, e cila sjell edhe rreshje te mëdha, ndërsa gjatë veres era fryn nga veriu dhe veriperendimi. Afersia me detin bën qe klima te jetë e bute dhe vetëm ne raste tepër te rralla temperaturat te bien nën zero. Temperatura mesatare vjetore lekundet nga 150C-160C. Klima e Fierit lejon zhvillimin e një bujqesie shumë degeshe.

Gjithashtu tokat bujqesore mund te shfrytezohen 2-3 here ne vit. Ne kuadrin e pasurive natyrore rëndësi te veçantë kanë pasurite ujore, ku përveç detit Adriatik, rrethi pershkohet nga lumenjte Seman, Vjose e Gjanica. Semani -281 km i gjatë formohet nga bashkimi I Devollit me Osumin ne afersi te Beratit. Siperfaqja e pellgut ujembledhes është 5949 km², prurja mesatare vjetore e tij arrin ne 96 m³/sek. Semani është nder

lumenjte me eroziv, duke e bërë lumin me eroziv në vend. Vjose - 272 km l gjatë buron nga malet e Pindit ne Greqi.

Siperfaqja e pellgut ujembledhes është 6700 km²,ndërsa prurja mesatare vjetore e tij arrin 195 m³/sek. Gjanica - 67 km buron nga burimet e Pocemit e te Kalivacit.Siperfaqj a e pellgut ujembledhes është 234 km².Është një nga lumenjte me te ndotur në vend, për shkak te derdhjes se naftes. Rrethi ka dhe disa liqene artificiale ku me l madhi e me l rendesishmi prej tyre është ai l Kurjanit me siperfaqe 375 ha, ujerat e tij përdoren për ujitje. Bota natyrore bimore dhe shtazore e rrethit është transformuar nga veprimtaria e njeriut. Megjithatë rrethi l Fierit dallohet për disa lloje bimesh e kafshesh sidomos ne pjeset bregdetare e fushore.

Takohen disa lloje kafshesh si urithi, cakalli, nusja e lales, dhelpira, shkurteza, mellenja, thelleza e fushes si dhe disa lloje te ndryshëm zvarranikesh e gjarprinsh. Ndërsa ne ujerat e detit gjenden shumë lloje peshqish si qefulli, levreku, koca etj. Rrethi l Fierit bën pjes ne brezin e shkurreve dhe te pyjeve mesdhetare. Shkurret perbehen nga nenkati l makies,ku rriten shkurret me gjelberim te perhershem si mareja, shqopa, gjineshtra, dafina.

Ne këtë nenkat bimor rriten edhe disa drure te lartë si selvia, valanidhi, pisha e bute dhe e eger, qe ne disa raste formojne pyje te vegjel.

Nentoka është mjaft e pasur me lende djegese siç janë gazi natyror dhe nafta ku dallohet zona e Patos-Marinzes, e cila është dhe zona naftembajtese me e madhe ne Shqipëri. Gjithashtu nenetoka është e pasur dhe me materiale ndërtimi si zhavore, rerera, argjila etj.

Rrethi l Fierit është një nga rrethet ku shoqëria njerëzore ka demtuar botën e gjallë, si dhe me ndotjen mjaft te madhe te ajrit.Ne te bëjnë pjesë disa zona te nxehta mjedisore si : fusha naftenxjerrrese Marinez-Patos, Rafineria e Naftes Ballsh, AZOTIKU. Këto zona kanë sjelle ndotjen e dy lumenjve Gjanica dhe Seman, ujerave nentokesore dhe ne kombinim me automjetet e transportit,qe clirojne një numer të madh gazrash, pluhuri dhe bloze, si dhe kanë bërë qe Fieri te këtë edhe një ajër tepër te ndotur mbi normat e lejuara. Një nga problemet kryesore është edhe eleminimi i 850 m³ me tretesire arseniti dhe arsenati tepër helmues qe ndodhen ne Uzinen e Plehrave Azotike.

Ekonomia

Rethi l Fierit është ekonomikisht një nga rrethet me te zhvilluara te Shqipërisë. Ne këtë zhvillim vecojme tre periudha te rëndësishme kohore : paraclirimit, vitet 45-90-te dhe pas viti 1990.

Ne periudhën paraclirimit Fieri ka qenë një zone e prapambetur bujqesore, qe vuante nga kenetezimi masiv dhe malaria. Shumica e popullsise jetonte ne fshat ku ruheshin akoma disa karakteristika te feudalizmit. Një pjesë e fshataresise kishte toke, ndërsa pjesa tjetër punonte ne cifligjet e shtetit dhe ne ato private.

Ne vitin 1925 shoqëria anglo-persiane OIL Company mori për ta shfrytezuar për kerkimin e vendburimeve te naftes një siperfaqe prej 250.000 ha. Pas largimit te kësaj kompanie, vjen shoqëria AIPA qe morri për shfrytezim një siperfaqe prej 164.000 ha. Ne vitin 1938 ekzistonin magazina te mëdha mallrash dhe një rrjet l dendur tregtar.

Deget kryesore te ekonomise ne këto vite perfaqesoheshin me disa fabrika te industrise se lehtë dhe ushqimore. Ne 1937 dhoma e tregetise se qytetit numeronte 309 zejtare, tregtare dhe industrialiste. Pas pushtimit italiane vershuan shumë sipermarres, punetore , fermere , nenpunes, njerëz te profesioneve të ndryshme dhe bashke me ta dhe prodhimet e industrise italiane.

Ky fenomen u shoqerua me pasoja negative për prodhuesit vendas, kryesisht artizane, duke l rrenuar ekonomikisht dhe duke l detyruar te mbyllnin punishtet e tyre, gjë qe solli keqesimin e gjendjes ekonomike te familjeve të tyre. Pas kapitullimit te Italisë , pronat e shoqerise AIPA l mori ne dorë shoqëria gjermane Continental Oil.

Ne periudhën 45-90, Fieri kthehet ne një nga qendrat me te rëndësishme industriale te vendit. Këtu u ndertua kompleksi me l madh energjitiko-kimik l vendit. Ne prodhimin e pergjithshem industrial te vendit , Fieri zinte 12 % te tij. Deget kryesore te industrise ishin energjitika (nxjerrja e përpunimi l naftes, prodhimi l energjise elektrike), industria kimike, mekanike dhe ushqimore.

Për te mbështëtur këto dege te industrise se rëndë u ndertuan dy termocentrale, ne Fier dhe ne Ballsh. TEC-i i Fierit për nga kapaciteti ishte me l madhi ne Shqipëri me kapacitet 160.000 kw energji ne vit. Ne vitin 1952 u ngrit Uzina e Pastrimit te Pambukut, dhe me pas u ngriten edhe fabrikat e imdustrise ushqimore , si ajo e vajit, margarines, e veres etj. Strategjia ekonomike e ndjekur ne këto vite shtroi nevojën e zhvillimit te transportit automobilistik dhe hekurudhor.

Fillimisht u zhvillua transporti automobilistik me ngritjen e dy parqeve me te mëdha te vendit, parku automobilistik l Fierit dhe ai l transnaftes ne Patos. Me ngritjen e industrise se rëndë perparësi morri dhe transporti hekurudhor. Ne vitet 1967-68 u ndertua hekurudha Rrogozhine-Fier 53 km e gjatë, ne 1974-75 hekurudha Fier- Ballsh 26 km, ndërsa ne vitet 1981-86 ajo Fier-Vlore 35 km. Sipas statistikave bujqesore deri ne vitin 1985 Fieri kishte 5 NB dhe 20 kooperativa bujqesore.

Blegtoria u zhvillua dhe ajo si pjesë e gjithë kolektivizimit te bujqesise, por u vu ne plan te dytë. Ajo asnjëherë nuk l plotesoi tërë nevojat e popullsise. Megjthate edhe blegtoria pati një fare ecurie. Ne vitin 1985 ajo jepte 1/3 e prodhimeve bujqesore, ku rrethi Fier dallohej për numrin me të madh te gjetheve në vend, duke dhënë 1/5 e prodhimit te pergjithshem blegtoral. Komplekse blegtorale te rëndësishme kishin NB-te e Roskovecit dhe Levanit, kooperativat e Zharezes, Pojanit , Cakranit etj.

Periudha e tretë pas viteve 90-te është shoqëruar me ndryshime te mëdha edhe ne strukturen e ekonomise. Kjo si rezultat l ndryshimit te formes se pronesise, nga ajo shteterore ne atë private. Shumica e ndermarrjeve private te krijuara l perkasin aktivitetit trehtar, pas tyre vijjnë ato te sektorit te sherbimeve dhe te sektorit te transportit. Ne rrethin e Fierit ka pasur edhe mjaft investime te huaja kryesisht ne sektoret joproduktive te ekonomise si banka, ndertime, transport si dhe ne industrine tekstile.

Sot ne rrethin e Fierit ne industrine e nxjerrjes dhe perpunimit te naftes, veprojnë dy nga kompanite me te mëdha ne Shqipëri, Albpetrol dhe ARMO si dhe kompania kanadeze "Banker's ". Ndërsa përta l përket marredhenieve agrare, edhe ato njohen ndryshime rrenjesore. U kalua nga sistemi l kooperativave dhe NB-ve ne sistemin e prones private dhe te ekonomise te tregut te lirë. Ne rrethin e Fierit procesi l ndarjes se tokave ka përfunduar ne vitin 1993 dhe toka është shperndare sipas kriterëve te percaktuara ne Ligjin për Token.

Shperndarje e tokes është bërë ne varësi te sipërfaqes se përgjithshme te tokes se punueshme me numrin e banoreve. Kështu çdo person ka përfituar nga 0.15-0.3 ha. Këto kanë sjelle rritjen e shpejte te numrit te njesive te prodhimit bujqesor. Bujqesia private dominohet nga fermat qe operojne ne nivel familjar. Ndërkohë qe nga shoqatat e fermereve po krijohen ndermarrje të reja qe synojne drejt ekonomise se tregut bujqesor modern. Sot ne rrethin e Fierit sipas Zyres se Punesimt ka 72.237 te punesuar dhe 18.135 te papune, ndërkohë qe joekonomikisht aktive janë 51.052. Nga te punesuarit , 44.591 janë te gjinise mashkullore dhe 27.646 te gjinise femerore

Kushtet gjeografiko-natyrore

Rajoni Perëndimor zë pjesën pranadriatike te Republikës se Shqipërisë nga Hani i Hotit në veri e deri në Vlore në jug. Në perëndim rajoni laget nga deti Adriatik kurse në lindje kufiri kalon nga rrëza e Alpeve në veri drejt jugut, duke përfshire edhe sistemet kodrinore te Kerrabes, Dumrese, Mallakastres dhe kodrat e Vlorës në skajin e tij jugor. Brenda këtyre kufijve ky rajon ka shtrirje yeri-jug rreth 200 km dhe lindje-perëndim deri në 50 km. Në drejtim te lindjes, përgjatë luginave te Shkumbinit e te Osumit, rajoni shtrihet deri në Elbasan dhe Berat.

Në Rajonin Perëndimor mbizotëron relievi fushor i cili përbehet nga fusha te mëdha e mjaft pjellore, si për shembull: fusha e Myzeqesë, fusha e Durrësit dhe e Tiranës, fusha e Lezhës dhe e Shkodrës etj. Kurse relievi kodrinor zë sipërfaqe me te vogël dhe përbehet kryesisht nga grumbuj kodrinore mjaft te copëtuar në lindje (Kërraba, Dumreja, Mallakstra etj.) dhe nga disa vargje kondrinore në brendësi (Rodon Vore-Kërrabe, Divjakë-Ardenice etj.).

I gjithë Rajoni fushor Perëndimor dallohet për klime te ngrohte, ngaqë shtrihet pranë vijës bregdetare. Dimri është i bute dhe me lagështire, kurse vera e nxehte dhe thate. Kjo klime favorizon kultivimin e kulturave te ndryshme bujqësore, por që kane nevojë për ujitje në stinën e thate te verës.

Pasuria ujore është e madhe. Përveç daljes se gjere to rajonit në detin Adriatik, në te kalojnë dhe derdhen lumenjtë me te rëndësishëm te gjithë trevave shqiptare, si: Buna, Drini, Mati, Shkumbini, Semani, Vjosa etj. Duke rrjedhur në fushat e këtij rajoni, shtrati i këtyre lumenjve është i ceket dhe me mjaft dredhime. Për këto arsye janë te shpeshta vërshimet dhe përmytje. Gjithashtu, në pasurinë ujore te këtij rajoni përfshihet edhe liqeni i Shkodrës dhe disa liqene te tjera te vogla natyrore e artificiale.

Bimësia natyrore e rajonit është pothuajse e zëvendësuar tërësisht nga ajo e kultivuar, duke e kthyer kështu në rajonin me te rëndësishëm bujqësor te Shqipërisë. Tokat fushore janë tepër pjellore. Ato përbejnë bazën për zhvillimin bujqësor, prandaj sistemimi dhe mirëmbajtja e tyre paraqet rendësi te veçante.

Nga bota shtazore mund te përmendim zogjtë, shpendët dhe kafshët e ndryshme (fazanin, pelikanin, rosat e egra, lepurin etj.), që rriten pranë bregdetit, si në zonën e Lezhës, Divjakës, Nartës etj. Po kështu në pjesët kodrinore te rajonit hasen lloje te ndryshme shpendësh dhe kafshësh te egra. Rajoni, duke pasur sipërfaqe te lumenjtë, bën te mundur që në to te rriten edhe lloje te ndryshme peshqish.

Kushtet gjeografiko-natyrore te para se bashku përbejnë pasuri te mëdha natyrore për zhvillimin ekonomik te këtij rajoni. Kane qene pikërisht këto pasuri te shumta natyrore një nga faktorët kryesore që ka bere që ky rajon te jete sot nder me te zhvilluarit në te gjitha pikëpamjet, në krahasim me te gjitha rajonet e tjera te trevave shqiptare.

Teper e rëndësishme është ruajtja dhe vënia sa me mire në shfrytëzim e këtyre pasurive nga ana e njeriut. Kjo është detyrë e të gjithë brezave. Rajoni Perëndimor i Shqipërisë zë një pozite gjeografike të favorshme duke u shtrirë përgjatë gjithë brigjeve detare adriatike të Republikës së Shqipërisë. Është një rajon ku

mbizotërojnë fushat, klima e ngrohte, ujerat e shumta dhe tokat pjellore. Këto kanë bërë që ky të jetë sot rajoni më i zhvilluar i Shqipërisë në të gjitha drejtimet

Klima

I gjithë Rajoni fushor Perëndimor dallohet për klime të ngrohte, ngaqë shtrihet pranë vijës bregdetare. Dimri është i butë dhe me lageshtirë, kurse vera e nxehtë dhe thate. Kjo klime favorizon kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore, por që kanë nevojë për ujë në stinën e thate të verës.

Pasuria ujore është e madhe. Përveç daljes së gjërë të rajonit në detin Adriatik, në të kalojnë dhe derdhen lumenjtë si Shkumbini dhe Semani.

Duke rrjedhur në fushat e këtij, rajoni shtrati i këtyre lumenjve është i cekët dhe me mjaft dredhime. Për këto arsye janë të shpeshta vërshimet dhe perrmbytjet.

Tokat fushore janë tepër pjellore. Ato përbejnë bazën për zhvillimin bujqësor, prandaj sistemimi dhe mirëmbajtja e tyre paraqet rëndësi të vecantë.

Sizmiciteti

Trualli Shqiptar vendoset gjatë kufirit të përplasjes së dy pllakave të mëdha që levizin njëra kundër tjetres; pllakes Euroaziatike dhe asaj Arabo-afrikane, dhe është vater e përqendruar tërmetesh e cila preket me shpesh nga tërmete demtues.

Fieri si shumë zona të tjera të vendit është zonë e prekur nga tërmetet, ku nga pikepamja sismoteknike zona mund të goditet nga tërmete me magnitudë $M_{max}=5.5-6.0$ grade Richter me intensitet deri në 7 balle MKS-64 e cila shkakton çarje në mur dhe rrezim të copave të suvash por për objektet e uletë nuk parashikohen shqetësime. Si dhe mundësitë për të goditur tërmetet me shumë balle janë të vogla rreth 20%.

Gjeologjia dhe Dherat

Shqipëria si formacion gjeologjik është pjesë e përberësve të rëndësishëm alpin-mesdhetarë pjesë e degezimit Dinaro-albano-Helenid, ku në bëjmë pjesë tek Albanidet. Fieri si zonë e jashtme ben pjesë në Ultesirën Paramalore, dhe ndodhet në krahinën e ultesirës perëndimore, dhe karakterizohet nga shkëmbinj të dobët që i ben të paqëndrueshëm nga rreshqitja dhe është pjesë e sistemit neogjenik argjil, konglomerat ranor. Zona karakterizohet nga brezi i tokës së hirtë kafe, ku ajo vendoset mbi formacione sedimentare dhe sasia e humusit është e vogël rreth 2-4%. Në sheshin e ndertimit marrin pjesë formacione të neogjenit të përfaqësuara nga ndërthurje alevrolitesh argjilore e ranore si dhe nga depozita aluvilo-deluviale të kuarternit, trashësia e të cilit arrijnë deri në 25-30 m.

Hidrologjia, ujrat sipërfaqësore dhe nentokesore

Në këtë rajon takohen ujerat nentokesorë në depozitat zhavorr. Niveli i ujit nentokesor është 3.80m nga sipërfaqja e tokës por në pusët e shpimit ai arrijnë të ngrihet dhe të stabilizohet në 0.6-0.8 m thellesi dhe në varesi të stinës niveli i tyre ndryshon. Pasqyra e nivelit të përhershëm të ujerave nentokesorë luhaten sipas rreshjeve.

Ne zonen ku ushtrohet aktiviteti verehet se nuk ka burime sipërfaqesore ne distanca te aferta. Ne zonen e shfrytezimit dhe perreth saj nuk ka zona te lundrueshme dhe nuk ndodhen liqene dhe dete, prandaj gjate shfrytezimit nuk do te cenohen rruget ujore, brigjet bregdetare etj. Ne konturin anesor te zones dhe ne pjesen lindore te prones ne studim vihen re ish kanalet e drenazhimit qe kane ekzistuar per keto toka bujqesore.

Mjedisi biologjik

Vegjetacioni qe takohet ne kete zone fushore eshte tipik i mjediseve te ulta, anash rrjedhjeve ujore-kanaleve kullues te tokave bujqesore. Ne zonen ne studim te Fierit duke qene se jane perdorur per qellime bujqesore nga kooperativat para viteve '90 bimesia e zones ka qene e llojit te drithrave dhe pas lenies se saj djerre aty ka mbizoteruar bimesia barishtore dhe ne disa vende bimesi shkurrore. Aktiviteti ushtrohet ne nje objekt ekzistues dhe ne nje zone e cila ka sherbyer edhe me pare per qellime tregtare.

4 PERSHKRIMI I PROJEKTIT

4.1. Te pergjithshme mbi aktivitetin

Shoqëria "LIONA" Sh.a, me administrator Z. Klodjan Vathi do te ushtroje aktivitetin e tij prane rruges "Eleni Gjika", ne afersi te fshatit "Mbrestar Ferko", ne ambjentet e aktivitetit te depozitimit dhe tregtimit me shumice te naftes dhe nenprodukteve te saj.


Shoqëria "LIONA" sh.a ka marre me qira nga shoqëria "Resuli-Er" sh.a, dy depozita karburanti, perkatesisht me kodet :

- T-101 e cila ka kapacitet 2643 m³
- T-111 e cila ka kapacitet 591 m³

, ku ne total jane 3234 m³ hapësire magazinimi produktesh hidrokarbure sipas certifikatave te leshuara nga Drejtoria e Pergjithshme e Metereologjise.

Ne objekt jane te instaluara te gjitha paisjet dhe infrastruktura e nevojshme per zbatimin e kushteve teknike dhe te sigurta. Kushtet e punes jane bashkekohore dhe me standarte te larta sigurie.


Pershtatshmeria e paisjeve te transportit te produktit te mbetjeve te rrezikshme.



4.2. Vendodhja e aktivitetit

Aktiviteti i subjektit, do te ushtrohet prane rruges "Eleni Gjika", ne afersi te fshatit "Mbrostar Ferko", Bashkia Fier. Per ne hyrjen e objektit sherben rruga qe lidh lagjen "Mbrostar Ferko" me qytetin e Fierit dhe konkretisht me unazen verilindore. Objekti ndodhet rreth 2 km larg nga qendra e qytetit te Fierit.

Pamje satelitore e objektit ne vleresim



5. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS DHE MASAT PER MINIMIZIMIN E TYRE

Mjedisi eshte gjithmone i prekur nga veprimtarite e ndryshme qe ushtrohen ne te, por ndikimi mund te jete i ndryshem, kjo eshte e lidhur ngushte me vete llojin e veprimtarise e cila mund te kete impakt te drejtperdrejte, te terthorte, te rendesishem apo mesatar i pranueshem.

Nje nga objektivat e ketij raporti eshte identifikimi i ndikimeve te mundshme qe mund te shkaktohen ne mjedis nga ky aktivitet ne teresi. Identifikimi i ndikimeve te mundshme ne mjedisin e kesaj zone do te vleresohen ne njeren prej fazave kryesore; faza e operimit, pasi objekti eshte i ndertuar dhe ndikimi ne mjedis do te jete vetem nga funksionimi i paisjeve dhe linjes teknologjike. Nuk marrin ne konsiderate fazen pas perfundimit se veprimtarise pasi ky projekt do te vazhdoj te jete i tille dhe pas shume kohesh. Disa prej ndikimeve kryesore qe jane vleresuar si te mundshme jane paraqitur si me poshte.

Ndikimet e pritshme ne mjedis te analizuara gjate fazes se operimit te impiantit mund te permbidhen si me poshte:

1. Shkarkimet ne ujera vijne nga:

- a) proceset e ftohjes (kondensimit),
- b) ujrata e perdorura per qellime sanitare.

Lidhur me ujrata qe vijne nga perdorimi sanitar, ato nuk duhet te perzihen me ujrata industriale, por duhet te kalojne ne sistem kanalizimi dhe te lidhen me kolektorin e qytetit.

Duke respektuar procesin teknologjik, mundesite e ndotjes nga ujrata e shkarkimit do te jene te paperfillshme.

2. Ndotja e tokes si rezultat i rrjedhjeve te ndryshme gjate ngarkimit dhe shkarkimit te automjeteve apo makinerive, apo ne rast te emergjencave te mundshme;

Minimizimi i ndikimit ne mjedis lidhet me shkallen e trajnimit dhe ndergjegjesimit te punonjeseve te kompanise per te mos lejuar furnizuesit apo cdo firme kontraktuese qe siguron furnizimin me lende te pare, te shkaktoje rrjedhje te lendes se pare ne toke. Kompanite e kontraktuara duhet te detyrohen te perdorin pajisje te posacme, qe nuk lejone derdhjet e produkteve te naftes gjate ngarkimit dhe shkarkimit te tyre. Gjithashtu siperfaqja e tokes ku automjetet kryejne ngarkimin dhe shkarkimin e lendes se pare duhet te jete e betonuar.

3. Ndotja e ajrit vjen gjate procesit te riciklimit:

- a) si rezultat i avullimit te komponimeve hidrokarbure te avullueshme nga rrjedhjet e ndryshme dhe
- b) djegia e lendes djegese te gaste.

Nga rrjedhjet e mundeshme te naftes ndodh jo vetem kontaminimi i tokes, por per shkak te avullimit te hidrokarbureve ndodh edhe ndotja e ajrit nga komponimet organike. Impianti eshte dizenuar ne menyre te tille qe te keto depozita te jene te pajisur me element sigurie. Duke monitoruar shkarkimet ne ajer, kompania vlereson edhe efektivitetin e filtrave qe duhe te perdori, per te evituar ndotjen e ajrit ne mjedis. Nje avantazh i kompanise eshte edhe fakti qe impianti do te instalohet ne nje zone industriale, ku ndikimi i pritshem ne mjedis dhe shendet nga ky aktivitet eshte i ulet.

Siguria dhe ndikimet e pritshme ne shendet shkaktohen nga:

- 1. Rreziku nga zjarri
- 2. Rreziqet nga aksidentet industriale

Si cdo aktivitet tjeter industrial edhe ne kete rast, megjithe shkallen e sigurise qe ka vete dizenjimi i impiantit, masat e sigurise te marra nga kompania jane te domosdoshme, per te evituar rreziqet ne mjedis dhe shendet qe vijne nga zjarri per shkak te aksidenteve. Me poshte jane evidentuar edhe masat e mundeshme per te evituar dhe minimizuar rreziqet nga incidentet e ndryshme. Per kete subjekti duhet te zbatoje kushte te larta sigurie. Te vendosen postera sensibilizues dhe te njihet nga punetoret rregullorja e kushteve te sigurise gjate punes ne kete objekt.

